




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 333/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Infinitt” shpk – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “ILIR – KOSOVA” shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-18-1759-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datë: 06.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Infinitt” shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-18-1759-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-18-1759-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Infinit” shpk – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 23.03.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 26.04.2018, ku kanë marrë pjesë dymbëdhjetë (12) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: “Infinit” shpk – Prishtinë, si tenderues i eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 21.06.2018.

Njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 09.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Infinit” shpk – Prishtinë, me dt: 27.06.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 29.06.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Infinit” shpk – Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Infinit” shpk – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 09 Korrik 2018, me nr. 333/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Furnizim me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-18-1759-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 16, 59.2.4, 60, 72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.07.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik në raportin e dt: 26.07.2018, sqaron: se AK/ Komuna Prishtinë më datën. 04.06.2018, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës në web faqen e KRPP-së, dhe ka rekomanduar parashtruesin e ankesës, “Infinit” SHPK – Prishtinë. Kundër të njëjtit njoftim operatori ekonomik pjesëmarrës “Ilir Kosova shpk, më datën 05.06.2018, paraqet kërkesë për ri shqyrtim, me pretendimet ankimore se nuk është respektuar neni 56 dhe 59, të LPP-s, përderisa, më datën 07.06.2018, nxjerr vendim dhe aprovon kërkesën si të bazuar, ndërsa më datën 15.06.2018, publikon njoftimin për anulim të dhënies në KRPP. Më datën 21.06.2018, përmes letrës standarde njofton parashtruesin e ankueses mbi arsyet e eliminimit, rrjedhimisht më datën 26.06.2018, përgatit njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit përderisa me datën 29.06.2018, publikohet në KRPP, me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme.

Kundër arsyetimit të eliminimit, parashtruesi i ankues më datën 27.06.2018, paraqet kërkesë për rishqyrtim me pretendimet ankimore se nuk është respektuar neni 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 i LPP-s, ku AK/ Komuna Prishtinë, më datën 29.06.2018, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar dhe lë në fuqi njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Megjithatë AK, më datën 04.07.2018, nxjerr vendim tjetër dhe anulon njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit (pas kërkesës për rishqyrtim të OE “Ilir Kosova”shpk) dhe atë duke u bazuar në vendimin e panelit shqyrtues me nr. 55/18, i cili nuk lidhet me këtë aktivitet të prokurimit.

Sipas asaj që u përshkrua më lartë rezulton që AK/ Komuna Prishtinë, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së, si par. 2, të nenit 108/A, ku shprehimisht potencohet se, *“dorëzimi i një kërkesë për rishqyrtim e obligon AK, përkatës që automatikisht ta pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit...”*, përkatësisht nenin 112, par 1, përcakton, *“dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë...”*, përveç kësaj AK-ja, ndërmerr veprime tjera dhe me datën 09.07.2018, publikon njoftimin për dhënie të kontratës me të rekomanduar operatorin ekonomik “Ilir Kosova” shpk, me çmim prej 83 905 60 €, çmim i cili rezulton të jetë tejkaluar sipas vlerës se parashikuar nga AK-ja, ne dosje të tenderit dhe në njoftim për kontrate 80 000 00 €. (shif par 2, nënpar 2.1, të nenit 62, të LPP-së)

Në vijim po sqarojmë se pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me arsyetimin e eliminimit, *(Tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk plotëson kërkesat e specifikimit teknik, respektivisht kërkesat e përcaktuara në Aneksi I të dosjes së tenderit për pozicionin 2 – Projektor, dhe pozicionin 3 – Aparat fotokopjues), përkatësisht në pjesën C “Lista e Çmimeve, prodhuesit e pajisjeve, me konkretisht keni ofertua për pozicionin 2: Projektori, me prodhues BENQ, ndërsa për pozicionin 3: Aparat fotokopjues, me*

prodhuesin konica” konkretisht po t’i referohemi kërkesave të aplikuara në dosje të tenderit dhe specifikimeve teknike të detyrueshme, rezulton që AK vlerësimin e ofertave e ka bere ne kundërshtim me nenin 59, par 3, të LPP-s, përkatësisht par 3, të nenit 52 të LPP-s i cili përcakton, “*Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim...*”, pra AK përmes kërkesës për sqarim ka kërkuar, pranuar dhe trajtuar dokumentacion te cilin nuk e ka aplikuar përmes dosjes së tenderit apo njoftimit për kontratë, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës me ofertë ka prezantua deklaratën për specifikacionet teknike ku është deklarua se pajisjet e ofruara për këtë projekt janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike si në Aneksin 1, ku e njëjta deklaratë është e nënshkruar dhe vulosur. Prandaj pretendimet ankimore të përfshira në ankesë i kualifikojmë si te bazuara.

Përfundimisht në mbështetje të asaj që u përshkrua më lartë rekomandimi ynë për AK /Komuna Prishtinë, është qe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri vlerësim me qëllim të aplikimit të drejte të dispozitave të LPP-së, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të aplikuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të procesit të prokurimit eksperti shqyrtues vlerëson se nuk është respektuar: Neni 52 i LPP- së nga ana e AK-së, kur ka bërë vlerësim të ofertave me kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e DT-së, si dhe Neni 59 i LPP-së, ku AK nuk ka bërë vlerësimin të ofertat sipas kriterëve të FDT-së, që vet i ka përcaktua, në nenin 108/A dhe 112 të LPP –së, ku AK-ja , nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, pas kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Infinitt” shpk – Prishrinë, të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1 dhe 2), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë, me datë: 26.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: “Infinitt” shpk – Prishtinë, me datë: 27.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 06.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues-teknik të OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të

aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Hoxha deklaroj: Kompania 'INFINITT' pajtohet plotësisht me konstatimet ligjore të Ekspertit shqyrtues duke e konsideruar raportin e ekspertizës objektiv, profesional dhe ligjor. AK- KK Prishtine gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 16, 59.2, 59.4, 60, 72 dhe 108/a te LPP-se. AK padrejtësisht ka eliminuar kompaninë INFINITT SHPK nga tenderi ne fjale dhe pse oferta e konzorciumit INFINITT SHPK & GRAF TEK SHPK plotëson te gjitha kërkesat e parashtruara nga AK ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit. AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit nuk ka mare parasysh kursimin e buxhetit publik përkatësisht KK Prishtine dhe shpenzimin e parëse ne mënyrë sa me efikase dhe ekonomike konform nenit 1 dhe 6 te LPP-se, oferta e OE te rekomanduar për kontrata nga AK është e 10 me renditje për këtë aktivitet te prokurimit dhe ne vlere 9240.60 me e larte se oferta e kompanisë INFINITT SHPK po ashtu kjo oferte siç ka theksuar dhe eksperti bie ndesh me nenin 62.2 te LPP-se pasi qe tejkalon vlerën e parashikuar për këtë projekt nga AK.

Një fakt tjetër të cilin me duhet të paraqes pranë panelit shqyrtues është se AK-ja , gjate fazës se vlerësimit ka vepruar jashtëligjshëm po ashtu pasi qe ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertës vetëm për OE te rekomanduar për kontrate nga AK ne këtë mënyrë ka favorizuar OE ne fjale te cilin ka shpërblyer me kontrate dhe ka diskriminuar te gjithë OE tjerë pjesëmarrës pasi qe me këtë veprim ka paragjykuar fituesin e tenderit ende pa përfunduar procesi dhe afatet ligjore. OE INFINITT SH.P.K edhe pse nuk i është kërkuar nga AK ka bere vazhdimin e validitetit te ofertës konform nenit 31.4 te UOPP me 25.06. dhe 25.07. po ashtu me 25.07. konform nenit 31.5 te UOPP-se ka dërguar tek AK polisen/sigurimin e tenderit për 90 dite shtese. (këtë pretendim ankimor nuk e kemi cekur ne ankese pasi qe qasja nga AK i është ofruar OE me 10.07. je dita pasi qe e kompania INFINITT ka parashtruar ankesën ne OSHP). Me ane te deklaratës se specifikimeve teknike e kërkuar ne nenin 3.1 të FDT-së Autoritetit kontraktues i kemi garantuar se pajisjet e ofruara për projektin në fjale janë në përputhje të plote me specifikimet teknike si në ANEKS 1 prandaj edhe siç e kemi cekur ne ankese dorëzimi i katalogëve dhe përshkrimi i brendës nuk ka qene kërkesë ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit dhe AK nuk mund te beje vlerësimin e ofertave duke u hamendur apo bazuar ne kritere jo te matshme te cilat paraprakisht nuk kane qene pjese e njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit. Citoj nenin 59.4 te LPP-se: Autoriteti kontraktues, do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Bibaj deklaroi: Sqaroj se për këtë aktivitet kemi rekomanduar që të kthehet lënda në rivlerësim për arsye se AK-ja, për gjatë procesit të këtij aktiviteti ka bërë disa shkelje procedurale dhe ligjore të cilat i kemi sqaruese përmes raportit të ekspertizës, që kryesisht ndërlidhen me kërkesat e tejkaluara gjatë vlerësimit të ofertave, kundrejt ofertuesve në raport me ato të aplikuar në dosje të tenderit. Përveç kësaj OE ankues është rekomanduar fillimisht për dhënie të kontratës, pas kërkesës për rishqyrtim të OE-ve, pjesëmarrës anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, më pas anulohet i tërë aktiviteti i prokurimit, paraqiten kundër njoftimit për anulim përsëri kërkesa për rishqyrtim, AK nuk bënë pezullim të aktivitetit të prokurimit përkundër faktit se ankesa është paraqitur në OSHP dhe rrjedhimisht anulon njoftimin për anulim duke u thirrë në vendimet 55/18 i cili nuk lidhet me këtë aktivitet të prokurimit. Andaj kemi rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim kofnrom kërkesave që vet i ka aplikuar AK

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Hoxha deklaroi: I propozojmë edhe njëherë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën e OE ankues të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe rivlerësimi të bëhet kofnrom kërkesave të dosjes së tenderit e jo jashtë tyre.

Në fund eksperti shqyrtues z.Bibaj deklaroi: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës, konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se operatori ekonomik ankues është njoftuar nga ana e AK, lidhur me eliminimin me anë të letrës standarde të datës; 21.06.2018 ku thuhet “ Tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e specifikimit teknik të dosjes së tenderit respektivisht kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1, për pozicionin 2 projektor dhe pozicionin 3 aparat fotokopjuese” lidhur me këtë paneli shqyrtues sqaron se AK-ja, më datën; 04.06.2018, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës në web faqen e KRPP-së, dhe ka rekomanduar për kontratë parashtruesin e ankesës, “Infinit” SHPK – Prishtinë. Kundër të njëjtit njoftim operatori ekonomik pjesëmarrës “Ilir Kosova” shpk, më datën 05.06.2018, paraqet kërkesë për ri shqyrtim, me pretendimet ankimore se AK-ja, nuk ka respektuar neni 56 dhe 59, të LPP-së. Ndërsa, më datën 07.06.2018, autoriteti kontraktues nxjerr vendim dhe aprovon kërkesën si të bazuar, kurse më datën 15.06.2018 AK, publikon njoftimin për anulim të dhënies të kontratës në KRPP. Autoriteti kontraktues më datën 21.06.2018, përmes letrës standarde njofton parashtruesin e ankueses OE “Infinit” shpk – Prishtinë, mbi arsyet e eliminimit, rrjedhimisht më datën 26.06.2018, përgatit njoftimin për anulim të aktivitetit të

prokurimit përderisa me datën 29.06.2018, publikohet në KRPP, me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme.

Kundër arsyes se eliminimit operatori ekonomik ankues Infinit” shpk – Prishtinë, me më datën 27.06.2018, paraqet kërkesë për rishqyrtim me pretendimet ankimore se nuk është respektuar neni 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 i LPP-së, ku AK/ Komuna Prishtinë, më datën 29.06.2018, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar dhe lë në fuqi njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit. Megjithatë AK, më datën 04.07.2018, nxjerr vendim tjetër dhe anulon njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe aktivitetin e prokurimit në fjalë e kthen në rivlerësim (pas kërkesës për rishqyrtim të OE “Ilir Kosova” shpk) dhe atë duke u bazuar në vendimin e panelit shqyrtues me nr. 55/18, i cili vendim nuk lidhet me këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lendes të cilat i ka pas në dispozicion si dhe rrjedhën e këtij aktivitetit të prokurimit konstaton se autoriteti kontraktues, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së, si nenin 108/A, par. 2, ku shprehimisht potencohet se “dorëzimi i një kërkesë për rishqyrtim e obligon AK, përkatës që automatikisht ta pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit”, përkatësisht nenin 112, par 1, përcakton, “dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë” përveç kësaj AK-ja, ndërmerr veprime tjera dhe me datën 09.07.2018, publikon njoftimin për dhënie të kontratës me të rekomanduar operatorin ekonomik “Ilir Kosova” shpk, me çmim prej 83 905 60 €, çmim i cili rezulton të jetë tejkaluar sipas vlerës se parashikuar nga AK-ja , në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontrate 80 000 00 €. (shif par 2, nënpar 2.1, të nenit 62, të LPP-së)

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik për me arsyetimin e eliminimit, nga ana e AK-së se (Tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk plotëson kërkesat e specifikimit teknik, respektivisht kërkesat e përcaktuara në Aneksi 1 të dosjes së tenderit për pozicionin 2 – Projektor, dhe pozicionin 3 – Aparat fotokopjues), përkatësisht në pjesën C “Lista e Çmimeve , prodhuesit e pajisjeve , me konkretisht keni ofertua për pozicionin 2: Projektori, me prodhues BENQ, ndërsa për pozicionin 3: Aparat fotokopjues, me prodhuesin konica” konkretisht po t’i referohemi kërkesave të aplikuara në dosje të tenderit dhe specifikimeve teknike të detyrueshme, Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lendes konstaton se AK-ja, vlerësimin e ofertave e ka bërë në kundërshtim me nenin 59, par 3, të LPP-së, përkatësisht par 3, të nenit 52 të LPP-së, i cili përcakton, “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim...”, pra AK përmes kërkesës për sqarim ka kërkuar, pranuar dhe trajtuar dokumentacion të cilin nuk e ka aplikuar përmes dosjes së tenderit apo njoftimit për kontratë, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës me ofertë ka prezantua deklaratën për specifikacionet teknike ku është

deklarua se pajisjet e ofruara për këtë projekt janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike si në Aneksin 1, ku e njëjta deklaratë është e nënshkruar dhe vulosur. Andaj, pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues janë të bazuara.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lendes të cilat i ka pas në dispozicion konstaton që gjatë këtij aktivitetit të prokurimit nuk janë respektuar nenet 52, 59 , 108/A dhe 112 të LPP-së, andaj me rastin e rivlerësimit autoritet kontraktues duhet ta bëjë ekzaminimin ,vlerësimin dhe krahasimin e ofertave duke u bazuar vetëm në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna Prishtinë
- 1x1 OE - "Infinitt" SHPK – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.